



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 293, Datë 10.11.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBSOLAR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “ALBSOLAR PV PARK 1, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/10 prot., datë 08.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALBSOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar PV Park 1, me kapacitet të instaluar 2 MW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALBSOLAR” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1874 prot., datë 08.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar PV Park 1” me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si

dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A). Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “ALBSOLAR” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”, për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 2.1, gërmat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:  
**neni 9 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

*Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë*

*Pika 1.1. Aplikuesi ka depozituar të nënshkruar dhe vulosur Formatin e Aplikimit sipas rregullores së vjetër ndaj në të tilla rrethana në vijim duhet ta përcjellë sipas Shtojcës 1, gërmat “a”, “b”, “c” që është aktualisht në fuqi.*

*Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore (dëshmi penalteti) edhe për shoqërinë “ALBSOLAR” sh.p.k.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të përcjellë të nënshkruar dhe vulosur nga administratori strukturën organizative të saj dhe të bëjë me dije se cila pjesë e strukturës do të jetë në funksion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

*Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës*

- *Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:*

- **gërma “a”**: Në vijim shoqëria duhet të përcjellë të dhënat teknike për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas Shtojcës 2 të rregullores së licencimit si dhe të bëjë me dije nëse ka filluar punimet, apo fazën në të cilën ndodhen, duke qenë se ka deklaruar se data e fillimit të operimit do të jetë 30.12.2022. Po ashtu duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbi të cilin bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 49 vjet të centralit fotovoltaiik, pasi nga rastet analoge të mëhershme, ka rezultuar se jetëgjatësia e një centrali fotovoltaiik, teknikisht nuk mund të jetë më tepër se 25 vjet.

- Bazuar në aktet e përfaqësimit dhe në deklaratën e vetë shoqërive, vlerësohet e nevojshme që t'i drejtohem edhe MIE-s me një shkresë ku t'i kërkohet informacion në lidhje me shoqërinë që do të operojë centralin fotovoltaik “Albsolar Pv Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBSOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar Pv Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**